



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI

Seanca plenare e Kuvendit

SP-005

Prishtinë, më 3 dhe 4 tetor 2017

**P R O C E S V E R B A L**

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 3 DHE 4 TETOR 2017

Seancën e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 28 shtator 2017.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Më pas, kryesuesi procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 28 shtator 2017, njëzëri është vendosur që shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian të bëhet me shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin për shmangien nga afatet procedurale për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Ai e ndërpreu seancën e sotme në orën 17:00 për t'i vazhduar punimet nesër, më 4 tetor 2017, në orën 10:00.

\* \* \*

*E mërkurë, më 4 tetor 2017, ora 10:00*

*Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 3 tetor 2017*

Seancën plenare e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Kryesuesi procedoi me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Ai e hodhi në votim propozimin për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 92,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian shqyrtohet me shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Në vazhdim, kryesuesi e ftoi ministren e Integriteteve Evropiane që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Integriteteve Evropiane, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pas paraqitjes së projektligjit nga ministrja znj. Hoxha, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian diskutuan: Blerta Deliu-Kodra, në emër të Komisionit për Integritet Evropian; Dardan Sejdiu, në emër të GP të LVV; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP-LS; Ahmet Isufi, emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, emër të GP të “Nisma për Kosovën” dhe Duda Balje, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët: Islam Pacolli, Memli Krasniqi, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka dhe Fitore Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund, kryetarja e Komisionit për Legjislacion, znj. Albulena Haxhiu, paraqiti amendament në nenin 2 të Projektligjit, si në vijim: “Marrëveshja financiare për IPA-n 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian konsiderohet, e ratifikuar me 2/3-tat e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe hyn në fuqi në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me Kushtetutë të Republikës së Kosovës”.

Në këtë projektligj kishte paraqitur amendament edhe Komisioni për Integritet Evropian.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara.

Rezultat i votimit për amendamentin e Komisionit Funkcional për Integritet Evropian ishte, si në vijim:

Për ----- 93,  
Kundër ----- 7,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi amendamentin e Komisionit Funkcional për Integritet Evropian.

Rezultat i votimit për amendamentin e kryetares së Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit ishte, si në vijim:

Për ----- 101,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi amendamentin e propozuar nga kryetarja e Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Në fund, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, së bashku me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 98,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:10 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit:

Xhavit HALITI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*